

Treguesit demografikë


Tremujori IV – 2019

Tiranë, më 13 Shkurt 2020: Numri i lindjeve, për tremujorin e katërt 2019 është 7.910, duke shënuar një rritje me 8,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2018. Gjatë vitit 2019 kanë lindur 28.561 foshnja, duke shënuar një rënie me 1,3 %, krahasuar me një vit më parë.

Numri i vdekjeve, për tremujorin e katërt 2019 rezulton 5.421, duke shënuar një rënie prej 0,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2018. Numri i vdekjeve, në vitin 2019 ishte 21.937 persona, duke shënuar një rritje me 0,6 %, krahasuar me një vit më parë.

Shtesa natyrore e popullsisë, në tremujorin e katërt 2019 shënon 2.489 lindje më shumë se sa vdekje, duke pasur një rritje me 33,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Ky tregues, për vitin 2019 është 6.624, duke shënuar rënie me 7,1 %, krahasuar me një vit më parë, (Fig.1).

Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë




Shqipëria karakterizohet nga një shtesë natyrore pozitive, ku lindjet vazhdojnë të tejkalojnë vdekjet, dhe koeficienti bruto i shtesës natyrore ndryshe nga shumica e vendeve të Bashkimit European është pozitiv. Ky koeficient për Shqipërinë është 2,5, dhe është më i lartë se disa vende të rajonit si Mali i Zi (1,2), Maqedonia e Veriut (0,8), Serbia (-5,4). Kosova, ndër vendet e rajonit e ka koeficientin më të lartë me 10,3 për një mijë banorë, (Fig.3 në faqen 5).

Për publikim: 13 shkurt 2020

Në tremujorin e katërt 2019, nëntë qarqe të vendit kanë shënuar shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në tre qarqe, shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Në tremujorin e katërt 2019, vlera më e lartë e shtesës natyrore regjistrohet në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.147 numrin e vdekjeve, ndërsa ai më i vogël regjistrohet në qarkun e Korçës, ku vdekjet tejkalojnë me 74 numrin e lindjeve.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T4 – 2019



Lindjet

Në tremujorin e katërt 2019, njëmbëdhjetë qarqe të vendit kanë shënuar rritje të numrit të lindjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ndërsa vetëm një qark ka pësuar rënie.

Në tremujorin e katërt 2019, numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 2.525 lindje, ndërsa ai më i vogël në qarkun e Gjirokastrës, me 160 lindje.

Rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të katërt 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, e zë qarku i Kukësit me 45,6 %, vetëm qarku i Elbasanit ka pësuar rënie me 2,6 %.

Gjatë vitit 2019, katër qarqe të vendit kanë shënuar rritje të numrit të lindjeve, në krahasim me vitin 2018, ndërsa tetë të tjerë kanë pasur rënie.

Numri më i madh i lindjeve shënohet në qarkun e Tiranës, me 9.321 lindje, ndërsa ai më i vogli regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, me 506 lindje, për vitin 2019.

Rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, e zë qarku i Kukësit me 15,9 %, ndërsa rënien më të madhe në përqindje e zë qarku i Lezhës me 7,6 %.

Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2018	2019	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2018	T4 - 2019	Ndryshimi tremujor në %
	Shqipëria	28.934	28.561	-1,3	7.319	7.910	8,1
1	Berat	1.184	1.147	-3,1	314	316	0,6
2	Dibër	1.564	1.608	2,8	414	416	0,5
3	Durrës	3.086	3.080	-0,2	762	866	13,6
4	Elbasan	2.927	2.768	-5,4	781	761	-2,6
5	Fier	2.636	2.600	-1,4	655	755	15,3
6	Gjirokastrë	527	506	-4,0	138	160	15,9
7	Korçë	1.634	1.750	7,1	390	439	12,6
8	Kukës	952	1.103	15,9	217	316	45,6
9	Lezhë	1.362	1.259	-7,6	357	362	1,4
10	Shkodër	1.976	1.859	-5,9	495	557	12,5
11	Tiranë	9.583	9.321	-2,7	2.423	2.525	4,2
12	Vlorë	1.388	1.437	3,5	342	397	16,1
	<i>*Të panjohur</i>	115	123	7,0	31	40	29,0

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja mungon. 1

Vdekjet

Në tremujorin e katërt 2019, gjashtë qarqe të vendit kanë shënuar ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ndërsa gjashtë të tjera kanë pasur rritje.

Në tremujorin e katërt 2019, numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit me 124 vdekje, ndërsa ai më i madh në qarkun e Tiranës me 1.378 vdekje.

Rënien më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të katërt 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, e zë qarku i Fierit me 12,1 %, ndërsa rritjen më të madhe në përqindje, e zë qarku i Kukësit me 21,6 %.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Gjatë vitit 2019, gjashtë qarqe të vendit kanë shënuar ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me vitin 2018, ndërsa gjashtë të tjera kanë shënuar rritje.

Numri më i vogël i vdekjeve shënohet në qarkun e Kukësit me 539 vdekje, ndërsa ai më i madhi, në qarkun e Tiranës me 5.389 vdekje, për vitin 2019.


Rënien më të madhe në përqindje të vdekjeve gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018 e zë qarku i Elbasanit me 5,6 %, ndërsa rritjen më të madhe në përqindje e zë qarku i Kukësit me 7,4 %.

Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2018	2019	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2018	T4 - 2019	Ndryshimi tremujor në %
	Shqipëria	21.804	21.937	0,6	5.458	5.421	-0,7
1	Berat	1.150	1.225	6,5	293	262	-10,6
2	Dibër	914	950	3,9	228	219	-3,9
3	Durrës	2.074	2.037	-1,8	514	579	12,6
4	Elbasan	2.188	2.065	-5,6	508	460	-9,4
5	Fier	2.484	2.405	-3,2	647	569	-12,1
6	Gjirokastrë	744	752	1,1	171	191	11,7
7	Korçë	2.089	2.123	1,6	544	513	-5,7
8	Kukës	502	539	7,4	102	124	21,6
9	Lezhë	975	973	-0,2	268	251	-6,3
10	Shkodër	1.811	1.789	-1,2	429	442	3,0
11	Tiranë	5.174	5.389	4,2	1.334	1.378	3,3
12	Vlorë	1.673	1.667	-0,4	416	430	3,4
	*Të panjohur	26	23	-11,5	4	3	-25,0

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar vdekja mungon.

Fig. 3 Koeficienti bruto i shtesës natyrore të popullsisë, 2018



Burimi: Eurostat - https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=demo_gind&lang=en

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Aneke

Tab. 3 Lindjet, tremujorët me të dhëna finale

Nr.	Qarku	IV-18	I - 19	II - 19	III - 19	IV - 19
	Shqipëria	7.319	6.257	6.655	7.739	7.910
1	Berat	314	258	251	322	316
2	Dibër	414	368	400	424	416
3	Durrës	762	669	703	842	866
4	Elbasan	781	567	678	762	761
5	Fier	655	596	555	694	755
6	Gjirokastrë	138	109	115	122	160
7	Korçë	390	407	443	461	439
8	Kukës	217	238	270	279	316
9	Lezhë	357	267	272	358	362
10	Shkodër	495	380	420	502	557
11	Tiranë	2.423	2.063	2.224	2.509	2.525
12	Vlorë	342	314	289	437	397
	<i>*Të panjohur</i>	31	21	35	27	40

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja mungon.

Tab.4 Vdekjet, tremujorët me të dhëna finale

Nr.	Qarku	IV-18	I - 19	II - 19	III - 19	IV - 19
	Shqipëria	5.458	6.361	5.149	5.006	5.421
1	Berat	293	369	336	258	262
2	Dibër	228	291	216	224	219
3	Durrës	514	569	452	437	579
4	Elbasan	508	618	488	499	460
5	Fier	647	719	540	577	569
6	Gjirokastrë	171	221	161	179	191
7	Korçë	544	611	548	451	513
8	Kukës	102	156	127	132	124
9	Lezhë	268	284	231	207	251
10	Shkodër	429	537	402	408	442
11	Tiranë	1.334	1.504	1.261	1.246	1.378
12	Vlorë	416	476	381	380	430
	<i>*Të panjohur</i>	4	6	6	8	3

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut,ku është regjistruar vdekja mungon.

Tab.5 Shtesa natyrore e popullsisë, tremujorët me të dhëna finale

Nr.	Qarku	IV-18	I - 19	II - 19	III - 19	IV - 19
	Shqipëria	1.861	-104	1.506	2.733	2.489
1	Berat	21	-111	-85	64	54
2	Dibër	186	77	184	200	197
3	Durrës	248	100	251	405	287
4	Elbasan	273	-51	190	263	301
5	Fier	8	-123	15	117	186
6	Gjirokastër	-33	-112	-46	-57	-31
7	Korçë	-154	-204	-105	10	-74
8	Kukës	115	82	143	147	192
9	Lezhë	89	-17	41	151	111
10	Shkodër	66	-157	18	94	115
11	Tiranë	1.089	559	963	1.263	1.147
12	Vlorë	-74	-162	-92	57	-33
	<i>*Të panjohur</i>	27	15	29	19	37

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton rastet për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja dhe/ose vdekja mungon.

Metodologjia

Të dhënat tremujore, për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve, sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).

Koeficienti bruto i shtesës natyrore: Shpreh shtesën natyrore të popullsisë për një mijë banorë.